

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Marrje me qira e mjeteve të transportit për asfaltim

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV 60180000-3 - Marrje me qira e automjeteve të transportit të mallrave me shofer, 60182000-7 - Marrje me qira e automjeteve industriale me shofer

VLERA E FONDIT LIMIT:

4,166,667 (kater milion e njeqind e gjashtedhete e gjashte mije e gjashteqind e gjashtedhete e shtate) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kavaje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës nr.8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të Nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël",

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve 2021, 2022 dhe 2023, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së parshikuar të kontratës. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta paraqitet

nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Sipas nenit 43 pka 2/c të VKM nr.285 datë 19.05.2021 ku citohet “ 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar”

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2020, 2021 dhe 2022 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit. Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mësipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor vetëm nga operatori i shpallur fitues përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:

a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten kontrata e shërbimit dhe faturën tatimore të shitjes (situacionet), ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.

b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten fatura tatimore të shitjes (situacionet), ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve "a" ose "b" e bën ofertën të kualifikueshme

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi se kanë në pronësi ose me qira :

- minimalisht 2 (dy) autobitumatriçe
- minimalisht 1 (nje) asfaltoshtuese me hapje të kraheve deri në 9 m
- minimalisht 1 (nje) asfaltoshtuese me hapje të kraheve deri në 6 m
- minimalisht 1 (nje) fadrom/skrep
- minimalisht 2 (dy) eskavator me goma
- minimalisht 1 (nje) freze gerryese asfalti me gjeresi 2m
- minimalisht 1 (nje) freze gerryese asfalti me gjeresi 1m
- minimalisht 1 (nje) freze gerryese asfalti me gjeresi 0.5m
- minimalisht 2 (dy) rrul asfati cilindër cilindër jo më pak se 8 ton
- minimalisht 1 (nje) rrul asfati me goma jo më pak se 12 ton

Kosto e transportit duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës. Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë leje e qarkullimit, certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit, foto perkatëse ballore dhe anesore.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike që merren me qira, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë kontratë noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të jenë leja e qarkullimit, certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat), foto perkatëse ballore dhe anesore.

Për mjetet dhe pajisjet që nuk pajisen me leje qarkullimi operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë dokument të vlefshëm që vërteton pronësinë apo marrjen me qira të tij dhe foto perkatëse (kontrate blerje apo zhdoganimi se bashku me faturat perkatëse, ndërsa për mjetet e marra me qira kontrate qiraje e noterizuar e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mjetet e paraqitura në ofertë nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do të jenë në dispozicion të objektit që tenderohet. Gjithashtu duhet të deklarojë vendodhjen e tyre me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë nga moment i paraqitjes së ofertës deri në përfundimin e kontratës mjetet e deklaruar si më sipër.

Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mësipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor vetem nga operatori i shpallur fitues përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Automjetet nevojitet për realizimin e shërbimeve të nevojshme sipas funksionit përkatës që ka secili mjet.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht:

- 5 (pese) Eskavatoriste/Makiniste/Manovratore për të cilët, duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet kompetente.

- 7 (shtate) Specialiste Asfaltoshtrues për të cilët, duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet kompetente.

Dokumentacioni provues, i cili vërteton kapacitetin profesional të stafit, personelin e nevojshëm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afatëve të ankimit. Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie (të vlefshme) të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA), si më poshtë:

☒ **ISO 9001:2015** (Sistemi i menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente të tij.

☒ **ISO 14001:2015** (Sistemi i menaxhimit Mjedisor) ose ekuivalente të tij.

Çertifikatat të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj. Çertifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast të Bashkimit

të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat ISO sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Operatorët ekonomikë, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021.